



## Me rastin e Asamblesë së tetë të Gjyqtarëve të EULEX-it, të mbajtur më 9 dhjetor 2009 në Prizren

**Asambleja e përbërë nga këta gjyqtarë:** Maria Giuliana Civinini, Guy Van Craen, Angela Kaptein, Anna Bednarek, Antoinette Lepeltier-Durel, Arkadiusz Sedek, Christine Lindemann-Proetel, Dragomir Yordanov, Emilio Gatti, Eija-Liisa Helin, Ferdinando Buatier de Mongeot, Francesco Florit, Gerrit-Marc Sprenger, Gianfranco Gallo, Hajnalka Karpati, Harri Katara, Klaus Huner, Johanna Schokkenbroek, Nikolay Entchev, Rositza Buzova, Torsten Koschinka, Vitor Pardal, Vladimir Kanev, Verginia Micheva-Ruseva

### Miraton VENDIMIN

Të diskutojë dhe miratojë *njzëri* këtë Këshillë për Këshillin Gjyqësor të Kosovës lidhur me mjetet e ndryshme për forcimin dhe mbrojtjen e pavarësisë së Gjyqësorit.

### K Ë S H I L L Ë

---

**Për:** Këshillin Gjyqësor të Kosovës

**Nga:** Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it, Komponenti i EULEX-it për Drejtësi

**Tema:** Këshillë për Këshillin Gjyqësor të Kosovës mbi mjetet e ndryshme për forcimin dhe mbrojtjen e pavarësisë së Gjyqësorit

---

Kryesia e Asamblesë së  
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rr. Luan Haradinaj,  
Avenjja e Policisë

Fahu postal 268, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381(0)38 222 0104111  
www.eulex-kosovo.eu

### Përmbledhje ekzekutive

Siç parashihet me nenin 3 të Veprimit të përbashkët të Këshillit të Bashkimit Evropian, të datës 4 shkurt 2008 për Misionin e Bashkimit Evropian të



Sundimit të Ligjit në Kosovë, ky mision ka për detyrë që *“(a) të monitorojë, të udhëzojë dhe të këshillojë institucionet përgjegjëse të Kosovës në të gjitha fushat që kanë të bëjnë me sundimin më të gjerë të ligjit (duke përfshirë shërbimin e doganës), duke mbajtur në të njëjtën kohë disa përgjegjësi ekzekutive”*.

Neni 2.4 i Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, i datës 13 mars 2008 (Ligji nr. 03/L-053) përcakton që: *“përveç ushtrimit të funksioneve gjyqësore në përputhje me dispozitat e neneve 3, 4 dhe 5 të këtij ligji, gjyqtarët e EULEX-it do të monitorojnë, udhëzojnë dhe këshillojnë gjyqtarët kosovarë për sa i përket parimit të pavarësisë së gjyqësorit dhe në përputhje me modalitetet e përcaktuara me anë të këtij ligji dhe nga misioni EULEX KOSOVE”*.

Në veçanti, këshillimi përmban qëndrimet formale dhe zyrtare të marra nga gjyqtarët e EULEX-it në mënyrë kolektive në Asamblenë e gjyqtarëve të EULEX-it dhe të drejtuara për organet vendore gjyqësore, legislative apo qeveritare për stimulimin e veprimeve të tyre në fushat përkatëse përgjegjëse. Me fjalë të tjera, udhëzimi ka për qëllim që të ofrojë këshillim profesional për organet përgjegjëse (MD, IGJK, Kryetarët e gjykatave, Gjykata Supreme, Parlamenti, Fakultetet Juridike) për të gjitha çështjet që dalin nga përvoja e monitorimit dhe udhëzimit. Këshillimi i ofron palës kosovare njohuri të thella të nevojshme për të ndërhyrë në ato fusha të sistemit të drejtësisë të cilat kanë nevojë për përmirësime të përgjithshme strukturore në sistemin gjyqësor dhe të cilat përmirësime nuk mund të arrihen përmes aktivitetit të udhëzimit vetëm nga ana e gjyqtarëve të EULEX-it.

Kryesia e Asamblesë së  
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rr. Luan Haradinaj,  
Avenyja e Policisë

Fahu postal 268, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381(0)38 222 0104111  
www.eulex-kosovo.eu

### **Hyrje dhe gjendja e tanishme**



Duke pasur parasysh dobësitë e tanishme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i cili është akoma në proces e sipër të ri-emërimit të plotë gjersa të përfundojë procesi i ri-verifikimit; pas pranimit se instrumentet e tanishme në dispozicion të gjyqësorit kosovar për të reaguar ndaj presionit të papërshtatshëm politik të drejtuar ndaj një gjyqtari të vetëm apo ndaj gjyqësorit në tërësi; dhe me një mirëkuptim të instrumenteve të duhura legjislative dhe të udhëzimeve të përshtatshme të përkrahura dhe të miratuara nga KGjK-ja dhe nga organet kompetente legjislative me qëllim të sigurimit të pavarësisë së gjyqësorit, Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it ka aprovuar këtë këshillë duke dashur t'i përkujtojë KGjK-së disa nga instrumentet tashmë në dispozicion në praktikat më të mira evropiane dhe të dëshmuara si efikase për pavarësinë e gjyqësorit.

Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it, në këtë këshillë, paraqet mjetet e ndryshme në dispozicion për mbrojtjen dhe përkrahjen e pavarësisë së gjyqësorit kosovar, disa prej të cilave bien në kompetencat e drejtpërdrejta të KGjK-së për zbatimin e saj autonom, siç janë:

- Rregulloret e brendshme dhe udhëzimi i KGjK-së lidhur me mënyrën e reagimit ndaj çfarëdo presioni i cili mund të vë në rrezik pavarësinë e sistemit gjyqësor apo të një gjyqtari të caktuar
- Rregullat për përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve duke u mbështetur në kriteret objektive dhe të vendosura paraprakisht
- Rregullorja e vendosur paraprakisht për caktimin e posteve, hapave në karrierë dhe funksioneve të bartësit, promovimeve në karrierë, dhe transferimit të gjyqtarëve;
- Mjetet para një trupi të pavarur kundër vendimeve dhe mendimeve të kryetarëve të gjykatave, të cilat mund t'i dëmtojnë karrierat e gjyqtarëve;

Kryesia e Asamblesë së  
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rr. Luan Haradinaj,  
Avenjja e Policisë

Fahu postal 268, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381(0)38 222 0104111  
www.eulex-kosovo.eu



- Organizimi i trajnimeve të përshtatshme, duke përfshirë gjithashtu edhe strukturën ekzistuese;
- Përkrahja dhe ndihma ndaj shoqatës së gjyqtarëve në nivel lokal dhe ndërkombëtar.

Disa nga këto mjete kërkojnë veprime politike dhe legislative dhe prandaj përshkruajnë reformat ligjore dhe administrative të cilat KGjK-ja mund t'i promovojë. Promovimi do të drejtohet nga KGjK-ja te organet kompetente legislative dhe administrative si organ vetëqeverisës dhe përfaqësues i gjyqësorit për të siguruar marrjen e shpejtë të masave të duhura administrative dhe ligjore, në mesin e të cilave:

- Rregullimin me ligj të statusit dhe të karrierës dhe menaxhimin e tyre nga një trup i pavarur vetëqeverisës;
- Përcaktimin e pagës në gjyqësor, e cila duhet të hiqet nga kontrolli i drejtpërdrejtë i politikës;
- Mosndryshimin e pozitës së gjyqtarit;
- Normën për rregullimin e procedurës disiplinore e cila do t'i përmbushte të gjitha garancitë e drejtësisë;
- Që Kryetari i gjykatës të mos ketë autoritet hierarkik, por që kompetencat e Kryetarëve të Gjykatave të përcaktohen nga çështjet administrative dhe dispozitat ligjore;
- Një proces të ndershëm, transparent dhe të drejtë të riverifikimit;

**Rëndësia e parimit sipas të cilit 'gjyqtarët i nënshtrohen vetëm ligjit':**


**Mbrojtja e gjyqtarëve prej ndikimit të papërshtatshëm**

### **1. Parimi i përgjithshëm: 'gjyqtarët i nënshtrohen vetëm ligjit'**

Kryesia e Asamblesë së  
Gjyqtarëve të EULEX-it  
Gjykata Supreme e Kosovës

Rr. Luan Haradinaj,  
Avenjja e Pollicisë

Fahu postal 268, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381(0)38 222 0104111  
www.eulex-kosovo.eu



Parimi ‘gjqqtarët i nënshtrohen vetëm ligjit’ është një shtyllë themelore e sistemeve bashkëkohore gjyqësore duke ndjekur parimin e ndarjes së kompetencave.

Kjo gjë është e konfirmuar në: aktet kushtetuese<sup>1</sup>, konventat ndërkombëtare, rekomandimet dhe opinionet<sup>2</sup>, deklaratat dhe aktet e miratuara nga shoqatat e gjyqtarëve<sup>3</sup>, dhe një gjë e tillë radhitet në

<sup>1</sup> Shih, për shembull, ai Italian – neni. 101 – dhe ai i Gjeorgjisë – neni 84 - Kushtetutat, Kushtetuta e Kosovës, neni 102.

<sup>2</sup> Neni 6 i Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut: “çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme” (shih gjithashtu nenin 47 të Kartës së të drejtave themelore të Bashkimit Evropian – 2000/C 364/01)

**Rekomandimi Nr. R(94) 12 të Komisionit të Ministrave të KE-së mbi pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve:** “Në procesin e vendim-marrjes, gjyqtarët duhet të jenë të pavarur dhe të aftë të veprojnë pa asnjë kufizim, ndikimit të papërshtatshëm, shtytjeve, trysnisë, kërcënimeve apo ndërhyrjeve direkt apo indirekte, nga cilido drejtim apo për çfarëdo arsye. Ligji duhet të parashih sanksione kundër personave që kërkojnë të kenë ndikim në këtë mënyrë tek gjyqtarët. Gjyqtarët duhet të kenë liri për vendosjen e lëndëve paanësisht, në pajtim me vetëdijen e tyre dhe interpretimin e tyre të fakteve dhe në pajtim me rregullat sunduese të ligjit. Gjyqtarët nuk duhet të jenë të obliguar të raportojnë për meritat e lëndëve të tyre me askënd jashtë gjyqësorit”

**MENDIMI Nr 1 (2001) i CCJE mbi Pavarësinë e Gjyqësorit:** “Pavarësia e gjyqësorit është kusht paraprak për sundimin e ligjit dhe garantimit themelorë të gjykimit të drejtë. Gjyqtarët janë “të ngarkuar me vendimin final për jetën, liritë, detyrat dhe pronën e qytetarëve” (recitimi (përshkrimi) i parimeve themelore të KB-së, të pasqyruara në deklaratën e Pekingut; dhe në nenet 5 dhe 6 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut). Pavarësia e tyre nuk është e drejtë e posaçme apo privilegj i interesave të tyre personale por në interesin e sundimit të ligjit dhe të atyre që kërkojnë dhe presin drejtësinë.”

**Mendimi nr. 10 (2007) i CCJE mbi Këshillin për Gjyqësor:** Pavarësia e gjyqtarëve, në shoqërinë globale dhe të ndërvarur, duhet të respektohet nga secili qytetarë si garanci e së vërtetës, lirisë, respektit për të drejtat e njeriut dhe të drejtësisë së paanshme të lirë prej ndikimit të jashtëm. Pavarësia e gjyqtarëve nuk është e drejtë e posaçme apo privilegj i interesave të tyre personale por në interesin e sundimit të ligjit dhe të atyre që kërkojnë dhe presin drejtësinë. Pavarësia si kusht i paanësisë së gjyqtarëve i ofron garanci që qytetarët të jenë të barabartë para gjykatave.”

<sup>3</sup> See: the MEDEL (*Magistrats Européen pour la Democratie et la Liberté*) Declaration of Palermo, 1993, art. 2.1.: “Magistrates are subject only to legality and to the law.”; The Universal Charter of the judge, unanimously approved by the International Association of Judges in Taipei on November 17, 1999, art. 3: “In the performance of the judicial duties the judge is subject only to the law and must consider only the law”

Kryesia e Asamblesë së  
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rr. Luan Haradinaj,  
Avenya e Policisë

Fahu postal 268, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381(0)38 222 0104111  
www.eulex-kosovo.eu

mesin e parimeve esenciale të organizatave ndërkombëtare<sup>4</sup>. Parimi sipas të cilit “gjyqtari i nënshtrohet vetëm ligjit” duhet të konsiderohet si parim i përgjithshëm universal i cili udhëheq drejtësinë.

Si kërkesë minimale, ky parim kërkon me ngulm që:

- Gjyqtarët nuk duhet ti nënshtrohen autoritetit legjislativ dhe pushtetit ekzekutiv;
- Gjyqtarët duhet të jenë të liruar prej ndërhyrjeve të *jashtme* dhe të *brendshme*.

Gjyqtari i nënshtrohet vetëm ligjit është **parim dhe garanci e pavarësisë së Gjyqtarëve** të konsideruar si trupë dhe si persona të vetëm.

Pavarësia është mjeti kryesorë për sigurimin e **PAANËSISË** së gjyqësorit dhe i është dhënë gjyqtarëve jo si privilegj por si parakusht themelorë për paanësinë e tyre.

Gjyqtari i pavarur do të jetë në gjendje të vendos në mënyrë të paanshme dhe kështu të garantoj se çdokush është i barabartë para ligjit ; gjyqtarët nuk ka nevojë të brengosen apo frikësohen prej hakmarrjeve të mundshme që ndikojnë në ardhmërinë e tyre, karrierën e tyre, pagën e tyre, sigurinë dhe jetën e tyre dhe të familjes së tyre, ata duhet që “të mos shpresojnë asgjë dhe mos të frikësohen prej asgjëje”, ata duhet të jenë të pavarur!

## 2. Ndërhyrja apo trysnia e jashtme

<sup>4</sup> Neni 2 i parimeve themelore të hartuara prej KB-së: “gjyqësori do ti vendos çështjet para tyre në mënyrë të paanshme, në bazë të fakteve dhe në pajtim me ligjin, pa kurrfarë kufizimesh, ndikimeve të papërshtatshme, shtytjeve, trysnive, kërcënimeve apo ndërhyrjeve direkt apo indirekte prej cilitdo drejtimi apo të çfarëdo arsyeje”.

Neni 8 i parimeve themelore të KB-së : gjyqtarët “gjithmonë duhet të sillen në atë mënyrë që të ruajnë dinjitetin e pozitës së tyre dhe paanësinë dhe pavarësinë e gjyqësorit”.



Për të luftuar me sukses kundër ndërhyrjeve dhe trysnive të shfaqura në vetë gjyqtarin apo në gjyqësor si sistem, është e nevojshme: - të definohet çka është ndërhyrja apo trysnia; - të sqarohen treguesit e prezencës së këtyre ndërhyrjeve; - të vendoset se si të reagohet kundër ndërhyrjeve dhe si të mbrohen gjyqtarët kundër tyre.

#### **Ndikim i jashtëm mund të ushtrohet nga:**

- Ekzekutivi; ligjvënësi; qeveria lokale (vendore);
- Personat prej Qeverisë ; zyrtarët publikë apo ligjvënësit;
- Partitë politike;
- Elitat politike dhe ekonomike;
- Inteligjenca ushtarake dhe/ose paramilitare (paraushtarake);
- Rrjetet kriminale;
- Media.

#### **Ndikimi i jashtëm në gjyqtarin e vetëm apo në sistemin gjyqësor është:**

- Çfarëdo ndërhyrje e tepruar në procesin e vendimmarrjes;
- Çfarëdo mase administrative dhe legislative <sup>5</sup> që mund të dëmtoj lirinë: e vetëdijes, interpretimit dhe vendimit të gjyqtarit (gjyqtarëve);
- Çfarëdo veprimeve të grupeve të trysnisë apo të grupeve ndikuese të drejtuara në gjyqtarë;
- Çfarëdo veprimi i cili mund të shtyj gjyqtarin në shqetësime apo frikë që do të dëmtonte atë, apo familjen e saj/tij apo të gjërave të tij/saja.

#### **Kriteri objektiv dhe faktorët tregues për zbulimin e ndikimit të jashtëm mund të gjenden në:**

- Të ashtuquajturën “drejtësi telefonike”;

<sup>5</sup> Ndryshimet (shumë) të shpeshta të ligjit mund të konsiderohen ndërhyrje të tepruara në sistemin gjyqësor kur ato janë mjet për detyrimin e gjyqtarit që të miratoj zgjidhjen dhe/ose vendimin që – nga këndvështrimi faktik- është në interes të politikanëve apo grupeve politike/ekonomike

- Deklaratat publike të politikanëve (përfaqësuesve të Qeverisë ...)  
apo përfaqësuesit të grupeve të trypsisë apo interesit;
- Përbërja politikisht e orientuar e trupit (vetë-) qeverisës së  
apo/dhe trupave të tyre disiplinorë;
- korrupsioni;
- mungesa e garancisë së karrierës / ndërhyrjes politike në  
karrierën e gjyqtarëve.

### **3. Ndërhyrja e brendshme apo trysnia në vetë gjyqtarin apo në sistemin gjyqësor është:**

- çfarëdo ndërhyrje e tepruar në procesin e vendimmarrjes që vjen prej: përfaqësuesit të trupit qeverisës gjyqësor, Kryetarët e Gjykatave, anëtarëve tjerë të gjyqësorit – që në të vërtetë – mund të ndikoj direkt apo indirekt në karrierën apo statusin e gjyqtarit;
- mungesa e rregullave objektive dhe të paracaktuara në përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve;
- mungesa e rregullores në tërheqjen e lëndës nga gjyqtari;
- struktura hierarkisë së karrierës;
- mungesa e procedurës së garantuar disiplinore;
- mungesa e stafit dhe burimeve për përkrahjen e aktiviteteve gjyqësore.

### **4. Si të mbrohen gjyqtarët kundër ndikimit të tepruar të jashtëm dhe të brendshëm.**

Themelimi i trupit të pavarur të vetë-qeverisjes është mbrojtja e parë kundër çfarëdo lloji të ndikimit dhe ndërhyrjes në procesin e vendimmarrjes gjyqësore. Në Kosovë, trupi i vetëqeverisjes është parashikuar me nenin 108 të kushtetutës dhe ka detyrë të qartë të *siguroj pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor*. Është e një rëndësie të lartë që funksionet e KGJK-së dhe të drejtave të posaçme



kushtetuese të jenë në mënyrë adekuate të rrethuara dhe të mbrojtura me ligjin mbi KGJK-në, si garanci që Këshilli mund të punoj në mënyrë të suksesshme si *institucion tërësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të veta*.

Procesi i emërimit të anëtarëve të KGJK-së patjetër ka ndikim të fuqishëm në pavarësinë e trupit. Përvoja Evropiane tregon se, pavarësisht prej përbërjes së këshillit – i cili është qartë i themeluar nga kushtetuta e Kosovës- përzgjedhja e këshilltarëve nëpërmes procesit të duhur zgjedhor jep dinjitet dhe pavarësi më të lartë për anëtarët e këshillit se sa format e tjera të emërimit.

Në mendimin nr.10 (2007) të KKGjE-së për Këshillin Gjyqësor fuqimisht theksohet se: “Këshilli Gjyqësor ka për qëllim mbrojtjen e pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe pavarësinë e gjyqtarëve individual. ... Këshilli Gjyqësor është gjithashtu i obliguar ta mbrojë nga çfarëdo presioni i jashtëm apo paragjykimi i natyrës politike, ideologjike apo kulturore, lirinë e gjyqtarëve për ti vendosur lëndët me paanshmëri, në përputhje me ndërgjegjen dhe interpretimin e tyre të fakteve dhe në pajtim me rregullat ligjore në fuqi”.

Për ta përmbushur mandatin e tij në mënyrë adekuate dhe të duhur, Këshilli Gjyqësor duhet të përbehet nga shumica apo totali i gjyqtarëve<sup>6</sup> (dhe prokurorëve nëse janë pjesë e gjyqësorit) të zgjedhur nga kolegët e tyre. Duhet t’ju ofrohen burime adekuate që të sigurojnë mbrojtjen e duhur, të pavarur dhe funksionim autonom. Për t’ia mundësuar Këshillit Gjyqësor përmbushjen e detyrave të rëndësishme të mbrojtjes së pavarësisë së gjyqtarëve në mënyrë efektive, kompetencat në vijim duhet të bien në mandatin e tyre:

1. seleksionimi, caktimi, gradimi, zhvillimi i karrierës dhe vlerësimi i profesionalizmit

<sup>6</sup> Duhet të miratohet përfshirja e gjyqtarëve të nivelit më të ulët së bashku me gjyqtarët e lartë.



2. kodi i mirësjelljes dhe kodi disiplinor
3. masat disiplinore (përmes një Komiteti special)
4. administrimi i gjykatës/ administrimi i buxhetit të gjykatës
5. mbrojtja e imazhit të drejtësisë dhe imazhit të gjyqtarëve individual
6. trajnimi (i kufizuar në politika dhe udhëzime të një organi autonom, sikur një shkollë)

#### **5. Mbrojtja kundër ndikimit të jashtëm.**

Në Shtetet pas konflikteve apo në demokracitë e reja, gjyqtarët (nëse nuk rrimërohen plotësisht përmes një procesi të drejtë dhe të garantuar të rrimërimin) kanë kaluar përmes një presioni të rëndë politik dhe/ose kontrollit politik.

Është tejet e rëndësishme që gjyqtarët ta kuptojnë se ata duhet të veprojnë në mënyrë të pavarur në zbatimin e detyrave të tyre gjyqësore pa pasur frikë për sigurinë e tyre, karrierën dhe të ardhmen e tyre.

Është po ashtu e rëndësishme që opinioni publik të ketë njohuri se sa e rëndësishme është pavarësia e gjyqësorit në një shtet demokratik dhe, nëse është e nevojshme, duhet të jenë të gatshëm ta ngritin zërin kundër instancave politike.

**Mjetet kryesore për reagim kundër presionit të jashtëm janë si në vazhdim:**

**- Reagimi publik i Këshillit të Lartë të Gjyqësorit kundër çfarëdo llojit të presionit të jashtëm që mund ta rrezikoj pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe/ose të gjyqtarit individual:**

Çdo herë kur vërtetohet një sjellje që mund ta dëmtojë prestigjin dhe ushtrimin e pavarur të kompetencave, Këshilli duhet të reagojë publikisht.

Kryesia e Asamblesë së  
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rr. Luan Haradinaj,  
Avenjya e Policisë

Fahu postal 268, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381(0)38 222 0104111  
www.eulex-kosovo.eu



Për këtë qëllim një **rregullore e brendshme** duhet të miratohet duke e krijuar një procedurë të qartë dhe kushtet për paraqitjen e saj.

Shembull:

**Kushtet:** sjelljet e dëmshme për prestigjin dhe ushtrimin e pavarur të kompetencave që janë në gjendje ta ndikojnë rrjedhën normale apo kredibilitetin e funksionit gjyqësor apo të sistemit gjyqësor janë vendosur

**Procedura:** gjyqtari i ballafaquar me sjellje të tilla, Kryetari dhe/apo Kryeprokurori i gjykatës përkatëse, cilido anëtar i Këshillit mund të kërkojë intervenimin e Këshillit duke e dorëzuar një kërkesë me shkrim në zyrën e Kryetarit; Kryetari cakton një person raportues i cili e hap dosjen dhe përgatit lëndën për ta paraqitur para Këshillit. Mund të kërkohet nga Zyrat dhe Administrata Publike që të dërgojnë dokumentacionin përkatës. Dëshmitë (si artikuj të gazetave, video kasete, dokumente) mund të mblidhen. Në seancën e caktuar, personi raportues i drejtohet këshillit me rezultatet e hetimit. Ai/ajo mund të paraqesin propozim për këshillim me shkrim duke kërkuar nga Këshilli: - mbledhjen e dëshmnive (p.sh. dëgjimi i gjyqtarit, Kryetarit të gjykatës, personat e tjerë të njoftuar lidhur me faktet...); ta refuzoj lëndën; - të intervenoj publikisht për ta mbrojtur pavarësinë dhe prestigjin e gjyqtarëve dhe/ose të funksionit gjyqësor/institucionit.

Këshillimi duhet të miratohet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të Këshillit dhe duhet të publikohet në mënyrë adekuate.

**- Statusi dhe karriera e rregulluar me ligj dhe e menaxhuar nga një organ i pavarur vetëqeverisës**

Siç është theksuar tanimë, Këshilli i Gjyqësorit do të jetë organ me kompetenca ekskluzive mbi menaxhimin e karrierës së gjyqtarëve (emërimin, caktimin e posteve dhe funksioneve, ndryshimin,

Kryesia e Asamblesë së  
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rr. Luan Haradinaj,  
Avenjya e Policisë

Fahu postal 268, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381(0)38 222 0104111  
www.eulex-kosovo.eu



gradimin, vlerësimin) në bazë të ligjit dhe përmes një procedure të garantuar dhe transparente (miratimi i rregulloreve të brendshme që krijojnë procedura të qarta dhe transparente të bazuara në kritere objektive është tejet e rëndësishme).

Do të sigurohet pagë adekuate që ofron dinjitetin e funksionit, pa mundësi zvogëlimi.

Duhet të miratohet një rregullore e brendshme për implementimin dhe vlerësimin e profesionalizmit bazuar në kritere objektive dhe transparente.

#### **- Moslargimi**

“Është parim thelbësor i pavarësisë gjyqësore që mbajtja e pozitës është e garantuar deri në moshën e detyrueshme të pensionimit apo deri në skadimin e afatit të pozitës: shih parimet themelore të KB-ve, paragrafin 12; Rekomandimin Nr. R (94) 12 Parimin I (2)(a)(ii) dhe (3) dhe Parimin VI (1) dhe (2). Karta Evropiane konfirmon se ky parim shtrihet deri në emërimin apo caktimin në një zyrë apo lokacion tjetër pa pëlqim (përveç në rast të riorganizimit të gjykatës apo caktimit të përkohshëm), por të dyja Karta dhe Rekomandimi Nr. R (94) 12 parashikojnë se transferimi në detyrë tjetër mund të urdhërohet përmes sanksioneve disiplinore.” (Mendimi n. 1 CCJE)

#### **- Procedura Disiplinore**

Procedura disiplinore duhet të rregullohet me ligj me dispozita të:

- Garancisë procedurale;
- Të drejtës së plotë për mbrojtje;
- Vendimit të arsyetuar nga një organ i pavarur;
- Mjetit juridik të brendshëm ndaj organit të pavarur apo para Gjykatës Supreme.

Kryesia e Asamblesë së  
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rr. Luan Haradinaj,  
Avenjja e Policisë

Fahu postal 268, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381(0)38 222 0104111  
www.eulex-kosovo.eu



## 6. Pavarësia brenda gjyqësorit

Është e rëndësishë kritike mbrojtja e gjyqtarëve prej ndikimeve të jashtme dhe presioneve të tepërta, por edhe ndaj ndikimeve të brendshme që mund të rrjedhin nga Kryetari i Gjykatës, nga Këshilli si organ apo nga anëtarët e saj, nga një presion politik i brendshëm në gjyqësor.

Si të mbrohen gjyqtarët kundër ndikimit të brendshëm?

**Veglat kryesore** për parandalimin e presionit të brendshëm janë:

**- Rregullat në përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të bazuara në kritere objektive dhe të paracaktuara**

Duhet të themelohet një sistem transparent dhe objektiv i caktimit të lëndëve për të zbatuar parimin e para-caktimit të gjyqtarit (neni 6 ECHR) dhe për të shmangur ndërhyrjet në procesin e vendimmarrjes. Caktimi i një lënde një gjyqtari të caktuar dhe /ose një kolegji të caktuar, si dhe kompozimi i kolegjit, do të bëhet nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Gjykatës në bazë të kritereve objektive (automatike) dhe të qarta, të para-caktuara dhe vërtetuara. Ushtrimi i autoritetit diskret të Kryetarit mund ti hapë dyert e mundësisë konkrete për caktimin (apo mos caktimin) e lëndëve varësisht nga vendimi i parashikuar që gjyqtari mund të merr dhe, në fund edhe mundësisë për korrupsion.

Këshilli i Gjyqësorit duhet të miratojë një rregull të brendshme mbi "Përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve dhe përbërjen e kolegjeve" duke themeluar rregullat e përgjithshme që të gjitha Gjykatat duhet tu përmbahen. Në mes tjerash, Kryetari i Gjykatës duhet, pas konsultimit me gjyqtarët dhe me Odën e avokatëve vendorë, dhe Kryeprokurorin, të përpunojë një plan organizativ që përmban caktimin e gjyqtarëve në sektorë të ndryshëm (ligji civil, ligji administrativ, ligji penal) dhe kriteret konkrete për caktimin e

Kryesia e Asamblesë së  
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rr. Luan Haradinaj,  
Avenjja e Policisë

Fahu postal 268, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381(0)38 222 0104111  
www.eulex-kosovo.eu



lëndëve të gjyqarëve. Plani duhet ti dërgohet Këshillit i cili e miraton apo refuzon atë me rekomandime.

**- Dispozitat ligjore të autorizimeve të Kryetarit të Gjykatës**

Autorizimet e Kryetarit të Gjykatës duhet të vendosen qartazi me ligj. Autorizimet diskrete janë të nevojshme në një masë të caktuar për të siguruar një menaxhim fleksibil të Gjykatës, por duhet të sigurohen me ligj dhe duhet të ushtrohen në mënyrë transparente dhe të kontrolluar.

**- Kryetari nuk ka autorizim hierarkik përveç çështjeve administrative**

Kryetarët e Gjykatave nuk duhet të kenë autorizime hierarkike mbi gjyqtarët të cilët duhet të jenë plotësisht të pavarur në ushtrimin e detyrave gjyqësore dhe të gjitha aktiviteteve që janë të dobishme për këtë funksion (menaxhimi i lëndëve).

**- Mjetet juridike para organit të pavarur kundër vendimeve dhe opinioneve të Kryetarit që mund të dëmtojnë karrierën e gjyqarëve**

Këshilli Gjyqësor duhet të miratojë një rregullore të brendshme që vendosë mjet juridik kundër çdo vendimi (p.sh. caktimi në një sektor, shpërndarja e punës, kriteret e caktimit) apo çdo mendimi (p.sh. vlerësimi i profesionalizmit) të Kryetarit të Gjykatës, që mund të dëmtojë karrierën e gjyqarëve. Gjyqtari i interesuar duhet të ketë të drejtën e paraqitjes së mjetit juridik para Këshillit që mund të vendosë të pranojë vendimin apo të vërtetojë mendimin e Kryetarit, apo ta refuzojë atë me rekomandime.

**7. Roli i trajnimit**

Kryesia e Asamblesë së  
Gjyqarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rr. Luan Haradinaj,  
Avenyja e Pollicisë

Fahu postal 268, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381(0)38 222 0104111  
www.eulex-kosovo.eu



Rëndësia e trajnimit në ndërtimin e vetëdijes mbi pavarësinë dhe paanshmërinë duhet të potencohet.<sup>7</sup> Këshilli Gjyqësor duhet të promovojë trajnime nismëtare dhe të vazhdueshme të gjyqtarëve përmes një shkolle të pavarur (si IGJK). Gjersa shkolla duhet të jetë e lirë në shtjellimin e metodave dhe programeve më të mira të trajnimit, Këshilli duhet të ofrojë udhëzime adekuate në veçanti në fushën e etikës, deontologjisë, pavarësisë, efikasitetit të punës gjyqësore.

### **8. Roli i shoqatës së gjyqtarëve**

Rekomandimi i Kryeshefit të Ekzekutivit, Parimi IV thotë se « Gjyqtarët duhet të jenë të lirë për të formuar shoqata, si vetë ashtu edhe bashkë me organe tjera, të ruajnë pavarësinë e tyre dhe të mbrojnë interesat e tyre.” Shoqata e Gjyqtarëve, në nivel lokal si dhe në nivel Rajonal e ndërkombëtar, promovon ndarjen e praktikave më të mira, leksioneve të mësuara dhe forcon vetëdijen e gjyqtarëve si kategori, duke e forcuar pavarësinë e kësaj kategorie si tërësi. Prandaj, ndihmesa, promovimi dhe përkrahja e formave të ndryshme të shoqatave të Gjyqtarëve është e

<sup>7</sup> Shih në mes tjerash Mendimin n. 4 (2003) KKGJE: [...] “Pavarësia e gjyqësorit u jep të drejta gjyqtarëve në të gjitha nivelet dhe kompetencat, por gjithashtu edhe i ngarkon me detyra etike. Kjo e dyta përfshin edhe detyrën për të kryer punë gjyqësore në mënyrë profesionale dhe të kujdesshme, që do të thotë se at duhet të kenë aftësi të mëdha profesionale, që kërkohen, ruhen dhe rriten me anë të trajnimit që e kanë për detyrë, si dhe të drejtë ta kalojnë. 3. Është esenciale që gjyqtarët, të zgjedhur pas studimeve të plota ligjore, të marrin trajnime të hollësishme, të thella e të llojllojshme që të mund të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të kënaqshme. 4. Trajnimet e tilla janë garanci për pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre, në përputhje me kushtet e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Drejtave Themelore. 5. Së fundi, trajnimi është parakusht që gjyqësori të respektohet dhe të jetë e denjë të respektohet. Besimi që qytetarët e kanë në sistemin gjyqësor do të forcohet nëse gjyqtarët kanë njohuri të thella dhe të shumëllojshme të cilat shkojnë përtej fushës teknike të ligjit deri te fushat e rëndësishme shoqërore, si dhe shikattësi personale në gjykatore dhe një kuptueshmëri që u ndihmon atyre të menaxhojnë si duhet dhe me ndjeshmëri lëndët dhe të merren me të gjithë personat e përfshirë. Thënë shkurt, trajnimi është esencial për përbushjen e funksioneve gjyqësore në mënyrë objektive, të paanshme dhe kompetente, dhe për të mbrojtur gjyqtarët nga ndikimet e papërshtatshme.”

Kryesia e Asamblesë së  
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rr. Luan Haradinaj,  
Avenya e Policisë

Fahu postal 268, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381(0)38 222 0104111  
www.eulex-kosovo.eu



këshillueshme me qëllim të, *inter alia*, pasurimit të profesionalizmit të Gjyqtarëve, të rritjes së vetëdijes së Gjyqtarëve mbi rolin e tyre dhe përfundimisht të forcimit të deontologjisë së kësaj kategorie si tërësi.

## **Rekomandim**

Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it i rekomandon Këshillit Gjyqësor të Kosovës që seriozisht dhe urgjentisht të marr në konsideratë gjendjen e Gjyqësorit të Kosovës dhe nevojën e tij për mbështetje të mëtutjeshme për t'u zhvilluar si një organ i pavarur dhe i paanshëm. Me paraqitjen e mjeteve të ndryshme që janë në dispozicion për mbrojtjen dhe promovimin e pavarësisë së Gjyqësorit të Kosovës, Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it fton Këshillin Gjyqësor të Kosovës që t'i miratojë mjetet dhe masat e ekspozuara këtu të cilat bien në domenin e tij, dhe të jenë proaktivë në nxitjen e legjislativit Kosovar dhe Institucioneve përkatëse për miratimin e këtyre mjeteve që bien në përgjegjësinë e tyre.

Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it fton përzmërsisht Këshillin Gjyqësor të Kosovës që të kontaktojë dhe bashkëpunojë me Kryesinë e Gjyqtarëve të EULEX-it të kërkojnë këshilla dhe mbështetje për këto çështje. Gjyqtarët e EULEX-it dhe stafi i tyre do të jenë të gëzuar dhe të nderuar që t'u ofrojnë mbështetje kolegëve të tyre kosovarë për përmirësimet e këshilluara me të cilat do të përfitojë Gjyqësori i Kosovës dhe populli i Kosovës. Bashkëpunim i mëtutjeshëm mund të ofrohet për Udhëzimin e duhur për miratimin e mjeteve të sugjeruara dhe përpilimin e ndonjë dokumenti/mase përkatëse.

Kryesia e Asamblesë së  
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rr. Luan Haradinaj,  
Avenjja e Policisë

Fahu postal 268, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381(0)38 222 0104111  
www.eulex-kosovo.eu

Për arsyet e lartpërmendura Asambleja e tetë e Gjyqtarëve të EULEX-it:



## KËSHILLON

Këshillin Gjyqësor të Kosovës që të ndërmarrë masa për forcimin dhe mbrojtjen e pavarësisë së Gjyqësorit.

Maria Giuliana Civinini

Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it

Kryesia e Asamblesë së  
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rr. Luan Haradinaj,  
Avenya e Policisë

Fahu postal 268, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381(0)38 222 0104111  
[www.eulex-kosovo.eu](http://www.eulex-kosovo.eu)